

Nr. Regj. 24901/2011

02 / 02  
Nr. Llog. 02  
Llog. Nr. 02  
M. Llog. 02  
Prot. Nr. 03-2733/12  
Baz. 03-08-2012  
Date 03-08-2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Naser(Bislim)Shala, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6. 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe 198 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 31.07.2012 morri këtë:

## **A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET:** Procedura për kundërvajtje ndaj **Naser(Bislim)Shala**, i lindur më 26.10.1972 në Prizren, tani me vendbanim në lagjen "Ulpiana", C-2, Hyrja-1, nr. 4, në Prishtinë, ka kryer fakultetin ekonomik, Anëtarë i Bordit ART-së, në Prishtinë, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, për kundërvajtjen nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, komfor nenit 198 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkak se ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësin për kundërvajtjen. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë**, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-3214/2011 me datë 19.07. 2011 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Naser Shala, për kundërvajtjen nga neni 16 paragrafi 1. pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2011.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë deri më datën 31 mars 2011 pasi që nga ana e Gjyqtarit të EULEX-it, të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ferdinando Buatier de Mongeot, i është caktuar masa e paraburgimit me Aktvendimin GJPP nr. 25/10 prej datë 16.03.2011 i cili i është vazhduar deri më 16.04.2011 dhe pastaj përsëri i është vazhduar deri në muajin qershor kur është liruar nga aktakuza, në ç rast i është ndërprerë paraburgimi. Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit me një Shkesë nr. 295/2 të datës 6. maj 2011 e ka lajmëruar Agjencinë kundër Korrupsion se Anëtar i Bordit Naser Shala, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pasi që ndaj të njëjtit është caktuar paraburgimi nga ana e gjyqtarit të EULEX-it, duke kërkuar të mos iniciohet procedura kundërvajtëse për shkak të pamundësisë objektive të deklarin të pasurisë duke pas parasysh se formulari duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet personalisht nga vetë Naser Shala.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi përfaqësuesin e Agjencisë kundër Korrupsion Agron Behramin, i cili deklaroi se kanë marr shkresën nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, ku janë të njoftuar se Naser Shala, gjendet në paraburgim dhe se është suspenduar nga pozita e anëtarit të Bordit deri në përfundimit të procedurës penale, por pasi që nuk e ka bërë deklarin vjetorë të pasurisë në afatin e caktuar 31.03.2011, ndërsa provë nuk kanë pas se i është caktuar paraburgimi këta kanë ushtruar kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtje.


Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin të deklaratës së të pandehurit, deklarata e Agron Behramit, dhe vlerësimi i shkresave të tjera të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provave materiale të prezantuara gjatë seancës gjyqësore si janë Aktvendimet GJPP nr. 25/10 të datë 16.03.2011 me të cilin i është caktuar pastaj i është vazhduar deri më 16.04.2011 paraburgimi, e pastaj përsëri i është vazhduar deri në muajin qershor e deri në lirim nga aktakuza kur dhe i është ndërprerë paraburgimi, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri nuk mban përgjegjësi për këtë kundërvajtje pasi që e ka pas lirinë e kufizuar i është caktuar paraburgimi dhe nuk ka pas mundësi ta kryen këtë obligim ligjor, andaj në vështrim të nenit 198 par. 1 pika 2 të LK, **pezulloi** procedurën për kundërvajtje.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
Nr. Regj. 24901/2011, datë 31.07.2012

Gjyqtaria

Azra Cakolli

  
**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimin të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.